



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM Nr.33 Date 06.07.2021

“ TRAJTIMIN ME BONUS STREHIMI ”

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenin 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 77, pika 10, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Vendimin nr. 814, datë 03.12.2004, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, vendimin nr. 574, datë 29.08.2012, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, VKM Nr. 362 date 29.05.2019 Per kriteret e dhenies se subvencionit teqirase per kategorite qe gezojne perparesi ne subvencionimin e qirase ne tregun e lire, , me propozim te Keshilltarit Astrit Ademi ne mbledhjen e Keshillit Bashkiak te dates 06.07.2021 me 18 vota pro 2 vote kunder 0 apstenim


VENDOSI :

1. Lënjen në fuqi të vendimit 27 të datës 04.06.2021 të kthyer për rryshqyrtim nr.2002/1prot datë 22.06.2021 sipas shkreses se prefektit me prot 584/1.
2. Te miratoje bonusin per subvencionimin e qirase per familjen e z. Rezart Gjeci.
3. Efektet financiare do të përballohen nga buxheti i shtetit dhe buxheti bashkise ne masen 30 % te qerase.
4. Ngarkohen Drejtoria e Ekonomike dhe Sektori i Administrimit te Pronave dhe Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi ka efekt nga momenti i hyrjes ne fuqi deri ne nje vit.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Diber.

KRYETARI I KESHILLIT

SOKOL SAVA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.677/1.prot.

Peshkopi, më 21.07.2021

Lënda : Per vendimin nr.33, datë 06.07.2021 të Këshillit të Bashkisë Dibër

Drejtuar : KESHILLIT TE BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.33, date 06.07.2021 “Për trajtimin me bonus strehimi të qytetarit Rezart Gjeci”, ardhur pranë nesh më datë 15.07.07.2021 e regjistruar me nr 677 prot, konstatova se :

Në kundërshtim me Urdhërin e Ministrit të Brendshëm nr.175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe aneksin nr 1, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, aktit objekt verifikimi dhe shqyrtimi (edhe pas rishqyrtimit) , i mungon projekt-vendimi i paraqitur nga struktura përgjegjëse si dhe relacioni përkates që shpjegon respektimin e procedurës ligjore të nxjerrjes së tij, për të cilin kemi shpjeguar me shkresën nr.584/1 prot, datë 21.06.2021.

Në këto kushte, pavarësisht faktit se akte administrative të kësaj natyre prodhojnë pasoja individuale mbi palët, Prefekti e ka të pamundur të shprehet qoftë edhe në parim kur vëren se nuk janë respektuar normat proceduriale, për pasojë kërkohet që brenda afateve ligjore vendimi i depozituar pranë këtij institucioni të plotësohet me dokumentacionin e duhur ligjor nga strukturat përgjegjëse në të kundërtën konsiderohet i pavlefshëm.

